



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 05.06.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 02.06.2025 të parashtruar nga operatori ekonomik **AK INVEST DOOEL TETOVO** nga Tetova, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik AK INVEST DOOEL TETOVO, e datës 02.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 28.05.2025 të publikuar në platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 28.05.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, e konsideron të mbyllur aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori ekonomik **AK INVEST DOOEL TETOVO**, me datën 02.06.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 05.06.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1 - Qëllimi;

Neni 7 - Barazia në trajtim/Jo diskriminimi;

Neni 56- Dispozital e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;

Shkeljet e dispozitave- RREGULLORE NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (RRPP) janë:

Neni 30- Validiteti i Tenderit;

Neni 40- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Neni 43- Ndërprerja e procedurave të prokurimit;

Neni 97 - Shkeljet e rënda- Mos zbatimi i Vendimit të Panelit Shqyrtues OSHP:2024/1191 i datës 02.04.2025;

Pretendimet ankimore

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pas Ri-vlerësimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë me datën **28.05.2025** në platformën e E-Prokurimit ka bërë publikimin e Formularit Standard B 58- Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku ka marrë vendim që aktiviteti i prokurimit të anulohet.

Këtij Formulari ja ka bashkangjitur Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të Grupit të OE: "AK INVEST DOOEL TETOVO & HIDRO PROJEKT SH.P.K.

Bazuar në Raportin e Ri-vlerësimit të ofertave të datës **28.05.2025** shihet së Autoritetit Kontraktues ju kanë nevojitur **57 dite** pas vendimit të Panelit Shqyrtues OSHP:2024/1191 të datës **02.04.2025** për ta vlerësuar vetëm një oferte.

Në këtë Raportin të Ri- Vlerësimit të ofertave shihet së Komisioni i Ri vlerësimit të ofertave formalisht ka bërë ri-vlerësimin e ofertave dhe pothuajse copy paste ka marrë raportin e herës së kaluar të Ri-vlerësimit të ofertave për faktin se arsyet e eliminimit të ofertës tone të shënuara në Raportin e Rivlerësimit të ofertave të datës **28.05.2025** ndryshojnë substancialisht me arsyet e shënuara në Letrën Standarde për Tenderuesi e Eliminuar të datës 28.05.2025.

Gjithashtu ajo që është shume shqetësuese është fakti se , Komisioni i Rivlerësimit të ofertave ju ka referuar të gjeturave sipas Raportit të Ekspertit Shqyrtues e jo konstatimeve të Panelit Shqyrtues të shënuara në Vendimin Nr. OSHP:2024/1191 të datës 02.04.2025 dhe ne faqen 20 te raportit i referohet Raportit Nr.OSHP: 2024/1186.

Pretendimi Ankimor 1 - Shkelje e nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të LPP

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, Ri- vlerësimit të ofertave, eliminimit të ofertës tone dhe anulimit të aktivitetit të prokurimit për të dytën here radhazi, ka bere shkelje substanciale të nenit 1 të LPP që është qëllimi i ligjit dhe nenit 6 të LPP- Ekuonomiciteti dhe Efikasiteti për faktin se nuk kane arritur:

- Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve të Autoritetit Kontraktues;
- Të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës;
- Të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale të paanshme dhe etike;
- Të ndjekin parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike;
- Të parandaloj keqpërdorimin e pozitës zyrtare nga ana e Zyrtareve të Prokurimit gjate zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, anëtareve të Komisionit të Vlerësimit gjate Ri-vlerësimit të ofertave;
- Të parandaloj keqpërdorimin e pozitës zyrtare nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit edhe gjate aprovimit të Raportit të Ri-vlerësimit të ofertave të datës 28.05.2025;
- Të parandaloj keqpërdorimin e pozitës zyrtare nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit me rastin e marrjes se vendimit për eliminim të Grupit të OE: "AK INVEST DOOEL TETOVO & HIDRO PROJEKT SH.P.K.;
- Të parandaloj keqpërdorimin e pozitës zyrtare nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit me rastin e marrjes se vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit të datës 28.05.2025.

Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues – Ministrisë së Shëndetësisë për interesa krejtësisht personale pasi që nuk kane arritur ta shpërblejnë me kontrate Operatorin Ekonomik të preferuar (OE: BM-GROUP SH.P.K), që dy here radhazi e anulojnë aktivitetin e prokurimit se gjeja nuk kane pranuar oferta të përgjegjshme. Janë pikërisht këto interesa personale që i kane pa mundur Autoritetit Kontraktues që aktivitetin e prokurimit mos ta përfundojnë për me tepër se 17 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate.

Është shqetësues fakti që Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues fare nuk ndihen përgjegjës për zvarritjen e këtij aktiviteti të prokurimit dhe diskriminimin e Operatoreve Ekonomik edhe pse Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se Zyrtaret e AK kane bere shkelje gjate vlerësimit të ofertave kur kane marre vendim me datën 02.04.2024 që me kontrate të shpërblehet OE: BM-GROUP SH.P.K, (Vendimi OSHP:2024/0362 i datës 11.09.2024). Gjithashtu Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se Zyrtaret e AK kane bere shkelje gjate Ri vlerësimit të ofertave kur kane marre vendim më datën 21.11.2024 që aktiviteti i prokurimit të anulohet (Vendimi OSHP:2024/1191 i datës 02.04.2025).

Të gjitha këto që cekem me larte dëshmojnë se Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit qëllimisht kane bere shkelje substanciale të nenit 1 dhe nenit 6 të LPP.

Përshkrim i nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 i LPP

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellin duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërsa duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Pretendimi Ankimor 2 - Shkelje e Neni 7 të LPP - Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Autoriteti Kontraktues gjate Ri-vlerësimit të ofertave ka bere diskriminim të Grupit të OE: "AK INVEST DOOEL TETOVO & HIDRO PROJEKT SH.P.K.; për faktin së edhe pse Paneli Shqyrtues ka konstatuar së Ankesa e jone është e bazuar, Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues gjate Ri-vlerësimit të ofertave prape kane vazhduar me diskriminimin e grupit tone duke na eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për kritere te cilat nuk kane qene të shënuara ne DT dhe NJK me të vetmin qellim për ta favorizuar Operatorin Ekonomik të preferuar duke i dhënë mundësi që pas Ri tenderimit të ofertoj prape në këtë aktivitet të prokurimit.

Përshkrim i nenit 7 paragrafi 1 dhe paragrafi 6 plka (v) e LPP

1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

6.(v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies.

Pretendimi Ankimor 3 - Shkelje e neni 56, nenit 59 dhe 62 të LPP si dhe shkelje e nenit e neni 40, nenit 43 dhe nenit 97 të RRPP NR.001/2022

Autoriteti Kontraktues- Ministria e Shëndetësisë gjate Ri-vlerësimit të ofertave Grupit të OE: "AK INVEST DOOEL TETOVO & HIDRO PROJEKT SH.P.K. sipas Raportit të Ri-vlerësimit të datës 28.05.2025 ka bere shkelje substanciale të nenit 56 dhe 59 të LPP si dhe nenit 30, nenit 40 dhe nenit 97 të RRPP001/2022.

Zyrtaret e Autoriteti Kontraktues- Ministria e Shëndetësisë pas 57 dite nga data e Vendimit me datën **22.05.2025** përmes Platformës së E-Prokurimit na kane dërguar Letrën Standarde e Kërkesës për Sqarime të Tenderit.

Ne me datën 26.05.2025 përmes Platformës së E-Prokurimit ju kemi kthyer përgjigje për të gjitha pyetjet e kërkuara nga Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues.

Gjithashtu me datën 26.05.2025 ne forme fizike ju kemi dërguar në Zyrën e Portokolit të AK origjinalet e 9 (nëntë) Para Kontratave të Inxhinierëve sipas kërkesave që kane qene dhe 9 (nëntë) komunikimet përmes E-Mailit me Inxhinieret ku e kane konfirmuar nënshkrimin e Para kontratës.

Se bashku me këto Para Kontrata kemi dërguar edhe një Liste e stafit Profesional ku përveç tjerash ne këtë liste kemi shënuar edhe numrin e telefonit dhe e-mail adresat e Inxhinierëve ne menyre qe nëse Autoriteti Kontraktues ende ka paqartësi të komunikoj direk me stafin profesional lidhur me angazhimin e tyre në këtë projekt.

4.1.- Një Menaxher i Projektit – Inxhinier i dip. i Arkitekturës ose Ndërtimtarisë- Nuhi Nuhiu

- 4.2 - Një Inxhinier kryesor i punishtes Inxhinier i Operativës ne teren, Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – Konstruktive; - Safet Lipovica
- 4.3- Një Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës; - Blerim Bajraktari
- 4.4. – Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv;- Arberesha Kastrati
- 4.5. - Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Hidro; - Shpat Klaiqi
- 4.6. - Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës - Tension i lartë;- (Kusht i larguar nga dosja e tenderit)
- 4.8. - Një Inxhinier i diplomuar i Makinerisë; - Halim Halimi
- 4.9. - Një Inxhinier i diplomuar (bachelor ose master) i Gjeodezisë; - Fisnik Ismaili
- 4.10. - Një ekspert i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë.- Sami Lokaj

Për kërkesën 4.7 - Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës - Tension i ulët, nuk kemi dërguar origjinalin e Para Kontratës së kjo kërkesë është larguar nga kriteret sipas korigjimit që ka bere Autoriteti Kontraktues në Formularin B54- të datës 06.02.2024.

Bazuar në këto fakte nuk qëndron konstatimi i Autoritetit Kontraktues që ka shënuar në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 28.05.2025 së " Ne sqarimet e dorëzuara, ju nuk i keni dorëzuar te gjitha para kontratat siç janë kërkuar ne pyetjen sqaruese, mirëpo janë ofruar vetëm pjesërisht".

Ju si Autoritet Kontraktues gjate Ri-vlerësimit të ofertave na keni eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për një kriter të cilin nuk e keni kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate për faktin së në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate kërkesa ka qene që të dorëzohen dëshmi: **Kontratat ose marrëveshje të punës për këtë projekt (te noterizuara). Në asnjë vend nuk e keni shënuar së Kontratat ose marrëveshje e punës duhet të jene të noterizuara nga origjinali.** Ketë fakt e ka konstatuar edhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së në Vendimin OSHP:2024/1191 të datës 02.04.2025 në faqen 36 që ka të beje me ankesën tone ku shënon:

" Ndërsa lidhur me pretendimi nr.2: Pretendimet ankimore sa i përket stafit të OE ankues, i cili pretendon se dëshmitë për stafin janë ofruar në pajtim me kërkesat e dosjes sipas kërkesë se parashtruar nga AK tek Njoftimi për kontrate, Dosjes se tenderit dhe Formuarit për korigjimin e procedurës tek kërkesat mbi mundësit profesionale/teknike tek dëshmitë e dokumentuara është kërkuar "kontrata të noterizuara", **pa u përshkruar qe duhet te jene te notraizuar nga orgjinale.**

Paneli Shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk mund ta diskualifikoj një OE nga procedura e prokurimit për nje kriter i cili nuk ka qenë i paraparë ne NJK dhe DT-se sikurse parashihet ne nenin 56.3 i LPP-se citoj" *Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".* Sipas vendimit te OSHP se me nr 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367, ku nga gjetjet e panelit shqyrtues është kërkuar nga AK-ja qe gjate rivlerësimit te aplikon nenin 72 e LPP-se ne raste se ka dyshime mund te kërkon informata sqaruese për te vërtetuar aktin noterial apo ka mundur të aplikoj nenin 52.7 te LPP se. Mos respektimi i vendimeve të OSHP konform nenit 97 të Rregullores për Prokurimin Publik konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit. **Kështu që, PSH konsideron se nuk qëndron arsyetimet për eliminimin e këtij OE ankues lidhur me këto pika".**

Bazuar në këto të dhëna të shënuara në Vendim e Panelit Shqyrtues shihet së ju si Autoritet Kontraktues për qëllime të interesave personale dhe me qellim që me çdo kusht të na eliminoni nga aktiviteti i prokurimit keni dal jashtë mandatit tuaj ligjor duke mos respektuar Vendimin e Panelit Shqyrtues OSHP:2024/1191 të datës 02.04.2025.

Në Vendimin e Panelit Shqyrtues OSHP:2024/1191 të datës 02.04.2025 siç e cekem me larte shënon së ju si Autoritet Kontraktues nuk keni respektuar as Vendimin paraprak të Panelit Shqyrtues OSHP se me nr 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367 të datës 11.09.2024, dhe për këtë mos zbatim të vendimit Paneli Shqyrtues ju ka tërhequr vërejtjen:" Mos respektimi i vendimeve të OSHP konform nenit 97 të Rregullores për

Prokurimin Publik konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit"

Fatkeqësisht ju si Autoritet Kontraktues në vend që të veproni konforme Vendimit të Panelit Shqyrtues dhe të na shpërbleni me kontrate, të verbuar nga interesat personale vazhdoni me shkelje të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik duke mos respektuar prape Vendimin e Panelit Shqyrtues duke ju referuar konstatimit të Ekspertit Shqyrtues /Teknik e jo Vendimin të Panelit Shqyrtues OSHP:2024/1191 të datës 02.04.2025, kur shume qarte dihet se Paneli Shqyrtues nuk e ka mbështet raportin e eksperti shqyrtues dhe teknik për faktin se Eksperti Shqyrtues fare nuk ka pasqyruar gjendjen reale dhe aktuale lidhur me shqyrtimin e sqarimeve të dërguara, por vetëm i është referuar raportit paraprak të Ekspertizave paraprake dhe duke tentuar të inskenoni dhe fabrikoni kritere dhe fakte të pa qena me të vetmin qellim për të na eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.

Sa i për këtë pretendimeve tuaja spekuluese lidhur me nënshkrimet identike të para kontratave të këtij projekti me para kontratat e ofertës tone për projektin me titull: " Ndërtimi i QKMF në Istog" ne shkresën për sqarime që ju kemi dërguar me datën 26.05.2025 ju kemi sqaruar si me poshtë ,

Pyetje është jo profesionale, jo etike, diskriminuese dhe shpërfaqe tendencën e Autoritetit Kontraktues që me çdo kusht tenton që të na eliminoj nga ky aktivitet i prokurimit. Ju si Autoritet Kontraktues keni dale jashtë mandatit që ju takon për faktin se keni marre rolin e hetuesit. Megjithatë në do të përgjigjemi në këtë pyetje. Është normale që nënshkrimet e personave (stafit) të njëjte më qene të njëjtë në çdo dokument ku nënshkruajnë. Dyshuese dhe jo normale kishte me qene sikur këto nënshkrime të lshin ndryshe nga një projekt në projektin tjetër. Fakti që nënshkrimet janë identike dëshmon se para kontratat e stafit me të cilët kemi ofertuar në aktivitetin që ju si AK jeni duke e zhvilluar, janë dokumente të besueshme (valide) dhe se janë të nënshkruara nga vete staffi.

Sa i për këtë pretendimeve tuaja spekuluese lidhur me çmime jo normalisht të larta për pozicionet e para të punëve përgatitore , demolimeve dhe gërmimeve, ne shkresën për sqarime që ju kemi dërguar me datën 26.05.2025 ju kemi sqaruar si me poshtë:

Legjislacioni primar dhe sekondar i prokurimit publik i aplikueshëm ne Republikën e Kosovës në asnjë dispozite ligjore nuk njih termin "Çmim jo normalisht të larta".

Legjislacioni primar dhe sekondar i prokurimit publik i aplikueshëm në Republikën e Kosovës njih vetëm termin "Çmim jo normalisht të ulët" dhe bazuar në Nenin 41 paragrafi 6 i Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik që ka qene në fuqi në datën e publikimit të Njoftimit për Kontrate të këtij aktiviteti të prokurimit i lejohet Autoriteti Kontraktues që të kërkoj zbërthimi të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë, në rastin konkret vetëm nëse tenderi – vlera totale e ofertës konsiderohet si çmim jo normalisht i ulët.

Ju si Autoriteti Kontraktues këtë aktivitet të prokurimit e keni zhvilluar duke përdorur Dosjen e Tenderit – PUNE - PROCEDURE E HAPUR dhe në Përshkrimin e Çmimeve i keni të shënuara sasisht – pozicionet e të gjithë punëve që kane me u realizu gjate realizimit të kontratës.

Bazuar në këtë që cekem më larte juve si Autoritet Kontraktues nuk ju lejohet që të kërkon sqarime lidhur me shpjegim për artikuj – pozicione të caktuara për çmimit e larta e as me çmimit jo normalisht të ulët për faktin se siç cekem me larte ju aktivitetin e prokurimit e keni zhvilluar duke përdore Dosjen e Tenderit – PUNE - PROCEDURE E HAPUR dhe në Përshkrimin e Çmimeve i keni të shënuara sasisht – pozicionet e të gjithë punëve që kane me u realizu gjate realizimit të kontratës, pra nuk është kontrate kornizë me çmime për njësi.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë ne Njoftimin për Kontrate dhe Dosjen e Tenderit ka shënuar se Vlera e parashikuar për këtë projekt është: **22,513,201.67 €**

Oferta e jone është oferta e përgjegjshme me çmimin me të lire ne vlera totale prej: **21,989,734.33 €**,

Bazuar në këto të dhëna shihet se oferta e jone është për **523,467.34 €** me e ulët se sa vlera të cilën e ka parashikuar Autoriteti Kontraktues- Ministria e Shëndetësisë.

Sa i për këtë pretendimeve tuaj na paskemi vendosur të mos e bëjme zgjatjen e validitetit të ofertës dhe e paskemi diskualifikuar veten, kjo nuk qëndron për faktin se sikur të kishim vendosur të mos bëjmë vazhdimin e validitetit të ofertës në me datën 26.05.2025 nuk do kishim humbur kohe për të ju dërguar sqarimet që keni

kërkuar me datën 22.05.2025.

Arsyeja së pse në nuk jemi përgjigjur në shkresën për vazhdimin e validitetit të ofertave është:

Nga Platforma e E-Prokurimit ne e-mail adresën akinvest307@gmail.com me datën 22.05.2025 ne ora 2:29 PM na kishte ardhur Njoftimi së AK – Ministria Shëndetësisë ka dërguar B47 – Letër Standarde e Kërkesës për Sqarimet e Tenderit për procedurën "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK". Bazuar në këtë Njoftim në me datën 26.05.2025 ju kemi dërguar sqarimet e tenderit.

Pas pranimit nga ana e juaj të Formularit B58 – Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe pasi kemi lexuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar me datën 28.05.2025 kemi vërejtur së AK – Ministria e Shëndetësisë me datën 22.05.2025 ne ora 2:35 PM e kishte ngarkuar në Platformën e E-Prokurimit , Kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertave dhe sigurimit të tenderit edhe për 120 dite shtese.

Kemi shfletuar e-mailat që kane ardhur nga Platforma e E-Prokurimit dhe kemi vërejtur së së bashku (ngjitas) me e-mailit që kemi pranuar B47- Letër Standarde e Kërkesës për Sqarimet e Tenderit me datën 22.05.2025 në ora 2:29 PM kishte ardhur edhe e-maili për dërgimin e Kërkesës për vazhdimin e validitetit të ofertave po me datën 22.05.2025 në ora 2:35 PM –

Që të vjen nga platforma vetëm një e-mail për dy dokumente kjo nuk na ka ndodhur prej së ofertojmë në tender të Autoritetit Kontraktuese.

(Dëshmi E-mail i datës 22.05.2025).

Menjëherë me datën 28.05.2025 në ora 16:51 ju kemi dërguar Konfirmimin për vazhdimin e validitetit të ofertës edhe për 120 dite shtese dhe vazhdimin e Sigurimit të tenderit gjithashtu edhe 140 dite shtese.

Së ne nuk e kemi pare që Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë na ka dërguar Kërkesën për vazhdimin të validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit e dëshmon edhe vete fotoja që e keni ngarkuar në Letrën Standarde për tenderuesin e Eliminuar ku shihet së Dritarja që ka të dhënat e dërgimit të dokumentit e ka vetëm një tik. Bazuar në faktin që dritarja ka vetëm një tik e jo dy, ju shume mire keni qene të informuar që ne nuk e kemi hapur Kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës që ju e keni ngarkuar në Platformën e E-Prokurimit të Letrat Standarde dhe kjo ka qene dëshmi e mjaftueshme që ne nuk e kemi pranuar Kërkesën. Bazuar ne nenin Neni 30 - Validiteti i Tenderit të RRPP 001/2022 dhe interpretimit të KRPP-se pyetja nr. 7 e datës 22.11.2022 keni qene të obliguar të verifikoni së a e kemi pranuar kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit. Përkundër faktit që e keni ditur që ne nuk e kemi hapur dokumentin ju si Autoritet Kontraktues qëllimisht nuk keni marre asnjë veprim për të na informuar së na keni dërguar këtë kërkesë çoftë përmes e-mailit zyrtar apo telefonit.

Vendimin për anulim të aktivitetit të Prokurimit e keni marre ne kundërshtim të plote me nenin 62 të LPP dhe nenit 43 të RRPP 001/2022, për faktin se nuk qëndron konstatimi i juaj që nuk keni oferta të përgjegjshme pasi që oferta e jone i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues ne DT dhe NJK. Këtë e ka konstatuar edhe Paneli Shqyrtues në Vendimin OSHP:2024/1191 të datës 02.04.2025 vendim të cilin ju si Autoritet Kontraktues keni qene te obliguar që ta zbatoni. Oferta e jone është oferta e vetme e përgjegjshme me çmimin total i ofertës është për 523,467.34 € me e ulet së sa vlera të cilën e ka parashikuar Autoriteti Kontraktues- Ministria e Shëndetësisë.

Besojmë që keni njohuri së për shkelje të renda konforme nenit 99 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, sidomos kur dy here radhazi nuk e respektoni Vendimin e Panelit Shqyrtues iniciohet procedura për revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit.

Me keqardhje ju informojmë së nëse prape vazhdoni me këto shkelje të renda duke mos zbatuar Vendimet e Panelit Shqyrtues dhe duke na eliminuar pa asnjë baze ligjore nga aktiviteti i Prokurimit, ne do të kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të inicioj procedurën për revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit.

Përshkrim i nenit 56 paragrafi 3 i LPP

3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përshkrim i nenit 59 paragrafi 4 i LPP

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Përshkrim i nenit 62 paragrafi 1 i LPP

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitetet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyt:

2.1 Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Përshkrim i nenit 40 paragrafi 40.3 i RRPP 001/2022

40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Përshkrim i nenit 97 paragrafi (h) dhe (k) i RRPP 001/2022

h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së

k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Përshkrim i nenit 30 paragrafi 30.4 i RRPP 001/2022

30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohej para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit).

Përshkrim i interpretimit të KRPP-së pyetja nr. 7 e datës 22.11.2022

Konform nenit 87, paragrafi 2, nën paragrafi 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: "30.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshojë varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës". Neni 30.4 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: "30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohej para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)" "30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohej që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre". Sipas nenit 30.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohej zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit..." Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjisllacionit dytësor, nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë, KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në

kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkesë për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP) Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Duke u bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte, kërkojmë nga Autoritetit Kontraktues-Ministria e Shëndetësisë që Kërkesën tone për Rishqyrtim ta konsiderojë si të bazuar dhe lenden ta kthejë në Rivlerësim.

Gjithashtu kërkojmë nga Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues- Ministrisë së Shëndetësisë që të mos luajnë me profesionalizimin dhe integritetin e tyre personal si dhe me kredibilitetin e Institucionit- Ministrisë së Shëndetësisë por rivlerësimin e ofertave ta bëjnë konforme legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik që ka qene i aplikueshëm në kohen kur Njoftimi për Kontrate është publikuar për këtë aktivitet të prokurimit dhe ta zbatojnë në përpikëri Vendimin e Panelit Shqyrtues OSHP:2024/1191 të datës 02.04.2025 që ka të beje me Ankesën tone.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materialë deri në këtë fazë janë: Shpenzimet e përgatitjes së ofertës, shpenzimet e përgatitjes së tri Kërkesave për Rishqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së dy Ankesave për OSHP sigurimet e tenderit dhe fitimet e pritura.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Sa i përket pretendimit te parë ankimor per shkelje te nenit 1, par. 2 dhe 3 te LPP-se, konsiderojme se AK-MSh ka vepruar ne harmoni me keto nene, ndersa pretendimet tjera kane tjeter adrese.

Sa i përket pretendimit te dytë ankimor per shkelje te nenit 7 te LPP-se, konsiderojme se AK-MSh ka vepruar ne harmoni me kete nene, duke i trajtuar te gjitha ofertat ne menyre te drejte dhe meritore.

Sa i përket pretendimit te tretë ankimor per shkelje te nenit 56, 59 dhe 62 te LPP-se dhe 40, 43, 97 te RRPP, konsiderojme se AK-MSh ka vepruar ne harmoni me keto nene, duke i shqyrtuar me vemendje dhe profesionalizem dokumentat e ofruara nga ana juaj permes sqarimeve shitesë. Te gjitha keto pretendime jane trajtuar permes B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar, te dates 28.05.2025, te cilen e rikonformojme se oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si ne vijim:

Kontratat e stafit profesional nuk janë ne harmoni me kërkesën e NJK dhe DT, nuk janë te noterizuara si duhet dhe kjo eshte konstatuar edhe nga eksperti shqyrtues/teknik i cili pas analizimit të kësaj oferte, ka sqaruar se: "...dëshmitë e ofruara për një pjesë të stafit përfshirë këtu edhe z. Nuhiu i prezantuar si menaxher i projektit, janë vërtetim i kopjes nga kopja, pasi kontrata origjinale nuk i është prezantuar noterit, dhe si të tilla nuk plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit. Sqarojmë se kërkesa e dosjes ka qenë "kontrata të noterizuara", dhe kjo kërkesë

nuk plotësohet me vërtetim të kopjes nga kopja të kontratës, pa vërtetim të nënshkrimeve të palëve që lidhin kontratë në prani të noterit.”

Ne fletën e noterizimit nder te tjera theksohet se: ...dokument i cili ka 1 flete dhe 1 faqe, perputhet ne çdo aspekt me kopjen e zakonshme, me pare se me dokumentin origjinal, i cili nuk me është prezantuar. Fotokopjimi sipas Ligjit eshte bere ne zyren time. Pala deklaroi se origjinalin nuk e posedon me vete.

Përveç çështjes se noterizimit, gjate shqyrtimit me te detajuar kemi vërejtur se as Kontratat/Parakontratat te stafit nuk janë autentike për këtë aktivitet, pasi qe te njëjtat kane ndërlidhje me aktivitete tjera, oferta te te njëjtit OE ne MSh, andaj për AK këto kontrata nuk janë te pranueshme.

Sa i përket pikave tjera te kontestuara te kjo oferte, konsiderojmë se janë trajtuar ne vlerësimet paraprake andaj si komision nuk e kemi pare te nevojshme qe te trajtohen me shume.

Me date 22.05.2025: përmes platformës se E-prokurimit u janë kërkuar sqarime si ne vijim:

Bazuar ne vendimin e OSHP-se nr. **2024/1186** sipas te cilit aktiviteti eshte kthyer ne rivlerësim, AK-MSh eshte ne proces te rivlerësimit te aktivitetit, me ç`rast janë disa çështje qe duhet te sqarohen nga ana juaj, konform nenit 59.2 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Lidhur me Kërkesën e NJK dhe DT për stafin profesional (4.1, 4.2 deri te 4.10) te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkojmë sqarime rreth origjinalitetit te kontratave te inxhinierëve dhe nënshkrimet e tyre.

Kontratat e stafit profesional nuk janë te noterizuara si duhet dhe kjo eshte konstatuar edhe nga eksperti shqyrtues/teknik i cili pas analizimit të kësaj oferte, ka konstatuar se: “...dëshmitë e ofruara për një pjesë të stafit përfshirë këtu edhe z. Nuhiu i prezantuar si menaxher i projektit, janë vërtetim i kopjes nga kopja, pasi kontrata origjinale nuk i është prezantuar noterit, dhe si të tilla nuk plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit. Sqarojmë se kërkesa e dosjes ka qenë “kontrata të noterizuara”, dhe kjo kërkesë nuk plotësohet me vërtetim të kopjes nga kopja të kontratës, pa vërtetim të nënshkrimeve të palëve që lidhin kontratë në prani të noterit.”

Ne fletën e noterizimit nder te tjera theksohet se: ...dokument i cili ka 1 flete dhe 1 faqe, përputhet ne çdo aspekt me kopjen e zakonshme, me pare se me dokumentin origjinal, i cili nuk me është prezantuar. Fotokopjimi sipas Ligjit eshte bere ne zyrën time. Pala deklaroi se origjinalin nuk e posedon me vete.

Përveç çështjes se noterizimit, gjate rivlerësimit kemi vërejtur se Parakontratat e stafit tuaj për këtë aktivitet kane ndërlidhje me aktivitete tjera, konkretisht nënshkrimet e inxhinierëve janë identike me parakontratat e ofertës tuaj për projektin me titull “Ndërtimi i QKMF në Istog” me nr. prokurimi: 206-23-6380-5-1-2.

Marre parasysh se këto parakontrata nuk janë prezantuar ne origjinal as te noterit, si te tilla janë jo bindëse dhe AK i ka kontestuar edhe ne vlerësimet paraprake, andaj kërkojmë sqarim me dëshmi për këto parakontratata:

Pyetja sqaruese I:

Kërkojmë sqarime rreth nënshkrimeve identike te parakontratave te këtij projekti me parakontratata e ofertës tuaj për projektin me titull “Ndërtimi i QKMF në Istog”?

Na i siguroni Parakontratat origjinale te ofertës tuaj. Te gjitha parakontratat për këtë projekt te cilat janë te noterizuara ne formën e kontestuar nga AK (...dokument i cili ka 1 flete dhe 1 faqe, përputhet ne çdo aspekt me kopjen e zakonshme, me pare se me dokumentin origjinal, i cili nuk me është prezantuar. Fotokopjimi sipas Ligjit eshte bere ne zyrën time. Pala deklaron se origjinalin nuk e posedon me vete.) Meqenëse sipas përshkrimit te noterit ju si pale keni deklaruar se origjinalin nuk e posedoni me vete?

Pyetja sqaruese II:

Ne ofertën e juaj financiare vërehet se ka çmime jo normalisht te larta për pozicionet e para te punëve përgatitore, demolimeve dhe gërmimeve, sipas krahasimit te me poshtëm, andaj kërkojmë sqarime shtese për ofertën e juaj për këto tre pozicione te paramases?

Oferta juaj Ak Invest Doo & Hidro Project Shpk

RIKAPITULLIMI - ARKITEKTURA DHE STATIKA		
1	Punimet përgatitore dhe shërbimet	263,810.00 €
2	Punimet e demolimeve dhe pastrimet	871,235.00 €
3	Gërmimi, Punimet e dheut dhe mbushjet	184,790.00 €

Parallogaria e projektuesit:

RIKAPITULLIMI - ARKITEKTURA DHE STATIKA	
Punimet përgatitore dhe shërbimet	75,064.00 €
Punimet e demolimeve dhe pastrimet	88,820.00 €
Gërmimi, Punimet e dheut dhe mbushjet	113,110.00 €

Brenda afatit kohor ju jeni përgjegjgur duke dorëzuar përmes platformës se E-prokurimit sqarimet e kërkuara për çështjen e nënshkrimeve dhe krahasimit te çmimeve për pozicionet e punëve përgatitore.

Përmes arkivit ne MSH na janë dërguar ne kopje te forte fizike (origjinale) para kontratat për stafin profesional.

Për pyetjen sqaruese I:

Ne sqarimet e dorëzuara, ju nuk i keni dorëzuar te gjitha para kontratat siç i janë kërkuar ne pyetjen sqaruese, mirëpo janë ofruar vetëm pjesërisht: Një Liste të stafit profesional, parakontratat vetëm për stafin profesional dhe komunikimet përmes emailave me konfirmime te stafit profesional.

Këto parakontrata te dorëzuara ne forme fizike nuk janë autentike me Parakontratat e Ofertës se dorëzuar ne tender ne platformën e E-prokurimit.

Mos dorëzimi i parakontratave identike me ato te ofertës për këtë projekt, e bene ofertën tuaj te papërgjegjshme, meqenëse vërtetohet edhe deklarimet e noterit gjate noterizimit te tyre

(...dokument i cili ka 1 flete dhe 1 faqe, përputhet ne çdo aspekt me kopjen e zakonshme, me pare se me dokumentin origjinal, i cili nuk me është prezantuar. Fotokopjimi sipas Ligjit eshte bere ne zyrën time. Pala deklaroi se origjinalin nuk e posedon me vete.)

Për pyetjen sqaruese II:

Sqarimet e ofruara nuk janë bindëse për AK, meqenëse shihet ngritje shume e madhe e çmimeve te punëve përgatitore krahasuar me çmimet e projektuesit si dhe me çmimet e ofertave tjera ne konkurrencë. Bazuar ne RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK_A01 ne fuqi ne kohen e tenderimit, sipas te cilës ne nenin 4 ceket se:

4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik.

4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim:

- a) të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive;
- b) për aq sa është e mundur në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet, dhe
- c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.


Po ashtu me date 22.05.2025 përmes platformës se E-prokurimit i është dërguar kërkesa për vazhdim te validitet GOE Ak Invest Doo & Hidro Project Shpk, ku është kërkuar zgjatja e validitetit te ofertës edhe për 120 dite, dhe ne këtë shkrese ka qene e cekur “..Operatori ekonomik qe vendos te mos e beje zgjatjen e validitetit te ofertës dhe sigurimit, sipas përshkrimit te me sipërm, do te diskualifikohet si i papërgjegjshëm.

Ju nuk e keni bere zgjatjen e validitetit te ofertes deri me dt. 28.05.2025 (dita e gjashte nga kërkesa) ju nuk e keni zgjatuar validitetin e ofertës, andaj oferta eshte pa vlefshmëri dhe konsiderohet se ju keni vendosur te mos e bëni zgjatjen e validitetit te ofertës sipas përshkrimit te me sipërm dhe e keni diskualifikuar veten.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit